



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Bulevardi "Zog I", Godina 57/2

Tel. 04 268142; Fax 04268141

Nr. 390/7 Prot.

Tiranë, më 16.09.2016

V E N D I M
Nr. 102, datë 16.09.2016

“Mbi përfundimin e procedimit administrativ, filluar me urdhrin nr. 390/1 dt. 25.07.2016, të Komisionerit, për verifikimin e ligjshmërisë të veprimt administrativ të largimit nga puna të punonjësit **”***

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenet 11, pika 1, 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; neni 185 i ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2013, të Komisionerit, pas shqyrtimit të dokumentacionit, në lidhje me procesin e verifikimit të kërkesës nr. 390 Prot., dt.13.05.2016 të punonjësit të Zyrës Arsimore Librazhd, *****,

VËREJ SE,

Bazuar në informacionin në përmbajtje të kërkesës së paraqitur nga shtetasi ***** , regjistruar me nr. 390 prot., datë 13.05.2016, kanë lindur dyshime të arsyeshme se rasti i tij është trajtuar në kundërshtim me rregullat e përcaktuara në legjislacionin e shërbimit civil. Mosmarrëveshja e lindur, lidhet me faktin që nëpunësi ***** , me detyrë “Specialist në Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse”, në Zyrën Arsimore Librazhd, është larguar nga detyra me Vendimin nr. 10, dt. 21.08.2015, “Për largim nga detyra”, të drejtuesit të institucionit, me motivacionin, për shkelje të disiplinës në punë. Në këtë kërkesë pretendohet gjithashtu se, nëpunësi në fjalë, pa të drejtë, nuk është trajtuar si nëpunës civil, por si punonjës me kontratë pune dhe është larguar nga puna në bazë të dispozitave të Kodit të Punës.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të administruar dhe shqyrtimit të rrethanave të kësaj mosmarrëveshje, ka rezultuar se punonjësi ***** , fillimisht është punësuar pranë Zyrës Arsimore Librazhd, me aktin nr.18 dt. 10.02.2014, administruar si provë shkresore në dosjen administrative. Kjo marrëdhënie pune ka vazhduar deri në daljen e aktit administrativ nr. 10, datë 21.08.2015, “Për largim nga detyra”, për arsye të shkeljes së disiplinës në punë, objekt shqyrtimi i kërkesës së tij.

Ashtu si pretendohet prej tij, institucioni ku ai ka punuar nuk e ka trajtuar atë nëpunës civil, pavarësisht faktit që Departamenti i Administratës Publike, me cilësinë e njësisë përgjegjëse, me aktin nr. 2076/7, datë 17.10.2014, është shprehur se punonjësi ***** pas fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar ka fituar statusin e nëpunësit civil në periudhë prove, në pozicionin “Specialist në Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse”, në Zyrën Arsimore Librazhd.

Duke analizuar aktet e administruara ne dosje vërehet se, akti administrativ, objekt ankimi, i cili ka ndërprerë marrëdhënien e punës të ankuesit, pa të drejtë, përmban si referencë ligjore dispozitat e Kodit të Punës dhe kjo ka sjellë si pasojë që, kjo marrëdhënie me natyrë administrative, (sipas pikës 2 të nenit 1 të ligjit nr. 152/2013) nuk është trajtuar si e tillë, por është trajtuar si marrëdhënie pune me natyrë kontraktore. Në këtë mënyrë e ka trajtuar edhe Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës e cila me Vendimin nr. 1402, datë 18.12.2015, ka vendosur dëshmipërblimin e paditësit sipas dispozitave të Kodit të Punës.

Ndaj këtij vendimi, ka paraqitur ankim Zyra Arsimore Librazhd (nëpërmjet kërkesës ankimore nr.10 Prot., datë 08.05.2016), ankim i cili akoma nuk është shqyrtuar nga Gjykata Administrative e Apelit.

Duke qënë në këto kushte, nisur nga përmbajtja e nenit 36, të ligjit nr. 8116, datë 29.03.1996, “Kodi i Procedurës Civile i RSH”, në të cilin përcaktohet se: “Asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje që është duke u gjykuar nga gjykata”, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil nuk ka mundësinë për të trajtuar drejtpërdrejtë, pretendimet e ngritura nga punonjësi *****.

Por, nga ana tjetër, ka vend për evidentimin e shkeljeve të kryera/lejuara, të rregullave të administrimit të shërbimit civil nga ana e njësisë të burimeve njerëzore dhe drejtuesit të Zyrës Arsimore Librazhd dhe bazuar në kompetencën e parashikuar në nenin 14, pika 2, gërma “a”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të merren masat për rregullimin e gjendjes.

Arsyetimi dhe konkluzioni i mësipërm, bazohet në rrethanat që renditen më poshtë:

Punonjësi ***** është punësuar pranë Zyrës Arsimore Librazhd në datën 10.02.2014, si “Specialist në Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse”, në një kohë që ky institucion nuk ishte pjesë e shërbimit civil.

Momenti i fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, e ka gjetur ankuesin, pikërisht në pozicionin “Specialist në Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse”, në Zyrën Arsimore Librazhd.

Me fillimin e efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për shërbimin civil”, i ndryshuar, institucioni i Zyrës Arsimore Librazhd, u përfshi në fushën e shërbimit civil (shif, Lidhja 1, e VKM nr. 142 dt. 12.3.2014). Në kushtet kur, pozicioni i punës i ankuesit përfshihej në fushën e veprimit të këtij ligji dhe vetë ai plotësonte kërkesat e përgjithshme e të veçanta për tu deklaruar si nëpunës civil, Departamenti i Administratës Publike, bazuar në nenin 67, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe Kreun III, pika 2, të Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014 të Këshillit të Ministrave “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil”, me aktin nr. 2076/7, datë 17.10.2014, ka deklaruar statusin e tij të punësimit “Nëpunës civil në periudhë prove”, në pozicionin “Specialist në Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse”, në Zyrën Arsimore Librazhd.

Punonjësi ka vazhduar punën në këtë institucion deri në daljen e aktit administrativ të drejtuesit të institucionit, me nr. 10, dt.21.08.2015, *“Për largim nga puna”*, të tij, me motivacionin e shkeljes së disiplinës në punë.

Nga vetë përmbajtja e aktit objekt ankimi, konstatohet se punëdhënësi, Zyra Arsimore Librazhd ka patur një perceptim të gabuar në lidhje me natyrën dhe rregullimin ligjor të kësaj marrëdhënie pune dhe kjo ka bërë që akti administrativ të dalë në kundërshtim me ligjin material dhe procedurën ligjore që duhet ndjekur në rastin e zgjidhjes së një marrëdhënie pune në shërbimin civil.

Marrëdhënia e punës ndërmjet punonjësit ***** dhe Zyrës Arsimore Librazhd, për shkaqet që u renditën më sipër, rregullohet nga ligji nr.152/2013, *“Për nëpunësin civil”* i ndryshuar dhe pa qënë nevoja të analizojmë përmbajtjen e shkakut të ndërprerjes së marrëdhënies së punës, konstatojmë se në këtë rast, nuk është respektuar procedura e parashikuar në nenin 57 e vijues, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar dhe Vendimi nr.115, datë 05.03.2014, *“Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”*.

Në një eventualitet të tillë, kur pretendohet se nëpunësi ankues ka kryer veprime të kundraligjshme që përbëjnë thyerje të disiplinës në punë, drejtuesit të institucionit, me cilësinë e eprorit direkt, i lindte e drejta të fillonte ecurinë disiplinore, dhe nëse vlerësonte që shkeljet ishin të shkallës *“shumë të rënda”*, duhej t’ja kalonte për kompetencë shqyrtimi, Komisionit të Disiplinës, duke njoftuar për këtë njësinë përgjegjëse (*Departamentin e Administratës Publike*), e cila, sipas pikës 3, të nenit 59, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, kishte të drejtë të dërgonte përfaqësuesin e saj në këtë komision.

Mosrespektimi i procedurës së mësipërme, ka bërë që punonjësit ***** , ti mohohet një procedim i rregullt disiplinor, i cili garanton të drejtën për t’u njoftuar në lidhje me fillimin e procedimit, për t’u informuar lidhur me shkeljen faktike të pretenduar dhe provat për kryerjen e saj, të drejtën për t’u dëgjuar, për të paraqitur prova , të drejtën për mbrojtje juridike etj.

Nga ana tjetër, kjo masë disiplinore është marrë në kapërcim të kompetencave, nga drejtuesi i Zyrës Arsimore, dhe jo nga Komisioni i Disiplinës, siç urdhëron pika 2, e nenit 59, të ligjit nr.152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, gjë e cila, në vështrim të pikës *“b”*, të nenit 116, të ligjit nr. 8485 dt. 12.5.1999 *“Kodi i Procedurave Administrative të RSH”*, që ishte në fuqi në momentin e kryerjes së veprimit administrativ në fjalë, e që në bazë të nenit 185 të ligjit nr.44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”*, do të jetë dispozita efektive, përbën një shkak tjetër pavlefshmërie absolute të aktit.

Pra, për të dy arsyt e mësipërme, akti nr. 10, dt.21.08.2015, *“Për largim nga puna”*, të punonjësit ***** , është një akt absolutisht i pavlefshëm, e për rrjedhojë në kuptim të nenit 117/1, të ligjit të mësipërm, ai nuk sjell asnjë pasojë juridike, pavarësisht faktit nëse është deklaruar apo jo si i tillë, prandaj nëpunësit ***** , i lind e drejta të kthehet në pozicionin e tij të punës dhe të përfitojë gjithë të drejtat e tjera, që parashikon ligji, si pagën, vjetërsinë në punë, etj.

Në këtë vështrim, lind detyrimi që njësia përgjegjëse dhe njësia e burimeve njerëzore të Zyrës Arsimore Librazhd, duhet të drejtojnë procesin e konstatimit të pavlefshmërisë të aktit nr. 10, dt. 21.08.2015, *“Për largim nga puna”*, të punonjësit ***** , dhe të kryejnë veprimet e duhura administrative për rregullimin e gjendjes, ku përfshihet revokimi i aktit të largimit nga puna, kthimin e marrëdhënies administrative në gjendjen e mëparshme dhe njohjen e gjithë të drejtave ligjore të cenuara nëpunësit, nga akti i paligjshëm i largimit nga puna.

Ndërkohë, nëpunësit që kanë kryer/lejuar shkelje të ligjit, duhet të vihen para përgjegjësisë nga ana e njësisë përgjegjëse (Departamenti i Administratës Publike).

Për këto arsye:

Në bazë të nenit 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe nenin 34 të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2013, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Detyrimin e njësisë përgjegjëse dhe njësisë së burimeve njerëzore të Zyrës Arsimore Librazhd, të drejtojnë procesin e konstatimit të pavlefshmërisë të aktit nr. 10, dt. 21.08.2015, “Për largim nga puna”, të punonjësit *****, dhe të kryejnë veprimet e duhura administrative për rregullimin e gjendjes, ku përfshihet revokimi i aktit të largimit nga puna nr. 10 dt. 21.08.2015; kthimi i marrëdhënies administrative të cenuar në gjendjen e mëparshme dhe njohja e të drejtave ligjore të cenuara nëpunësit, nga akti i paligjshëm i largimit nga puna.
2. Të njoftohen për këtë vendim, Departamenti i Administratës Publike, Zyra Arsimore Librazhd si dhe nëpunësi *****.
3. Pas kryerjes së veprimeve të mësipërme, brenda 30 ditëve të njoftohet me shkrim Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA